

THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT

Oda e Avokatëve të Kosovës në bashkëpunim me Programin Kërko Drejtësi dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, Fakultetin Juridik të Univeritetit të Pejës, Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Prizrenit, fton anëtarët e saj të shprehin interesin e tyre për pjesëmarrje në Klinikën Juridike Penale (Live Legal Clinic) si avokatë mentorues për periudhën Tetor-dhjetor 2017.

Rreth Klinikës Juridike Penale:

Klinika Juridike Penale do tu ofrojë studentëve mundësi të punojnë në raste të vërteta penale gjatë vitit të katërt të studimeve të fakultetit juridik dhe të ndihmojnë avokatët e rinj gjatë përfaqësimit të klientëve. Klinika Juridike Penale me klientë të vërtetë i dedikohet sigurimit të ndihmës juridike falas për pjesëtarët e pafavorizuar të komunitetit. Në mënyrë që një person të bëhet klient, ai/ ajo duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Nuk kualifikohet për përfaqësim të detyrueshëm ex-officio
- Nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtjes
- Rasti duhet të jetë në fazën e hetimeve nga policia, në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatë Themelore ose në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore.

Roli the përgjegjësitë e akterëve të involvuar:

Studentët e juridikut, nën mbikëqyrjen e avokatëve të rinj, do të angazhohen në një gamë të gjerë të detyrave të avokatit si: intervistimi i klientëve, dhe këshillimi: hulumtimi; përgatitjen dhe argumentimi i kundërshtimeve; rishikimi i të dhënave; hulumtime ligjore që të sigurojnë mbështetje për teori të ndryshme ligjore; dhe të asistojnë në draftim dhe paraqitje të ankesave.

Avokatët e rinj do të përfaqësojnë klientët në gjykata dhe në të gjitha fazat tjera përgaditore pro-bono dhe to të mbikëqyrin studentët e vitit të katërt të fakultetit juridik gjatë punës së tyre me raste reale. Avokatët më me përvojë do të mbikëqyrin ata si pjesë e ngarkesës së tyre me lëndë pro-bono.

Avokatët me përvojë më të gjatë në profesion do të udhëheqin takime javore me qëllim që të finalizohet plani i ligjëratave dhe të mbikëqyrin avokatët e rinj në të gjitha aspektet e ngarkesës së tyre me lëndë, pro-bono. Dhe ky avokat, do të njoftojë avokatët e rinj për rastet e tij dhe të ftojë studentët e klinikës në monitorimin e seancave dhe në diskutime me ta pas seancës.

Komponenta e klasës së klinikës takohet njëherë në javë në fakulteti juridik të Universitetit përkatës duke përfshirë ligjëratat nga Kodi i Procedurës Penale dhe tryeza të rrumbullakëta për progresin e arritur nga studentët gjatë klinikës. Avokatët e rinj dhe ata me përvojë mund të tregojnë rreth praktikave të gjykimit gjatë ligjëratave të klinikës. Pofesionistë të tjerë ligjorë ose përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile do mund të ftohen si mysafirë.

Roli dhe përgjegjësitë e avokatëve të rinj:

Katër avokatë të rinj do të angazhohen **pro-bono** në detyrat si më poshtë:

- **Pro-bono** përfqëson minimum katër klientë në procedura në Departamentin e Përgjithshëm në Gjykatë Themelore, Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore ose në Polici;
- **Pro-bono** të ligjërojë në Klinikën Juridike Penale në ligjeratat që do të mbahet në Fakultetin Juridik të Universiteteve përkatëse;
- **Pro-bono** merr pjesë në aktivitetet e organizuara në shkolla të mesme nga Programi Kërko Drejtësi;
- Të mbajnë konsulta të rregullta dhe të jenë nën mbikëqyrje e një avokati më me përvojë, i caktuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, Universiteti dhe D4J.

Kushtet që duhen plotësuar për avokatët e rinj:

Me qëllim që të marrin pjesë në Klinikë si avokat të rinj, kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të kenë jo më shumë se tri vite përvojë si anëtar i OAK-së;
- Nuk duhet të jetë duke u zhvilluar procedurë disiplinore ndaj tij/saj;
- Të tregojë inters në përfaqësimin pro-bono, në minimum për 1 klientë brenda vitit;
- Mundësi për të pranuar 2-4 studentë të klinikës në zyrën e tij/ saj për konsultime dhe përfaqësim të klientëve;
- Aftësia për punë në ekip me student të Klinikës gjatë përfaqësimit pro-bono të klientëve;
- Interesim të demonstruar në reformën në gjyqësi, angazhim në komunitet, dhe qasje në drejtësi.
- .

Apliko

Anëtarët e interesuar të OAK-së për pjesëmarrje në këtë Klinikë Juridike Penale si avokat të rinj duhet të aplikojnë duke dërguar një letër për shprehje të interesimit përmes e-mail-it në info@ncsc-ks.org, deri më 27 tetor 2017.

Të interesuarit nga Rajoni i Prishtinës të shkruajnë në Subjekt **“Avokat të rinj-Pro-Bono në Prishtinë”**.

Të interesuarit nga Rajoni i Prizrenit të shkruajnë në Subjekt **“Avokat të rinj-Pro-Bono në Prizren”**.

Të interesuarit nga Rajoni i Pejës të shkruajnë në Subjekt **“Avokat të rinj-Pro-Bono në Pejë”**.

Të interesuarit nga Rajoni i Mitrovicës të shkruajnë në Subjekt **“Avokat të rinj-Pro-Bono në Mitrovicë”**.